

VENDIM
Nr. 914, datë 18.11.2020

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 586, DATË 10.9.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTAVE TË INVENTARËVE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT U KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHOQËRIVE ANONIME DHE NDËRMARRJEVE TË SISTEMIT TË TRANSPORTIT DETAR DHE AJROR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi "Portit Detar Vlorë" sh.a., bashkëlidhur vendimit nr. 586, datë 10.9.2004, të ndryshuar, i shtohet prona sipas planit të rilevimit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe "Porti Detar Vlorë" sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

